



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 17.01.2023

Nr: 03

Ora: 12:30

**VENDIM**

**PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 24, DATË  
06.01.2023 TË DEPOZITUAR NGA SHOQATA E TRANSMETUESVE RADIOTELEVIZIV  
KABLLORE VALORE**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 17.01.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio	BRAHO	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Koli	BELE	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

**KËRKUES:** "Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë Valorë"

**OBJEKT:** Kundërshtimi i vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

**BAZË LIGJORE:** Nenet 21, 123/1, 124/1, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja "b", neni 34, shkronja "b" dhe neni

35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

#### **VËREN:**

“Shoqata e Transmetuesve Radioteleviziv Kabllore Valore” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 24 regj., datë 06.01.2023. Në këtë kërkesë ankimore, subjekti kundërshton vendimin nr. 224/2022 të KSHZ në emër të OSHMA-ve :

- BBF, ERA DIGITALB, GLOB TV, TV ALPO, ANTENA NORD, TV APOLLON, TV BERATI, TV KLAUDIANA, TV KOPLIKU, TV KUKSI, TV LOBI, TV MATI, TV PREMIUM CHANEL, TV ROZAFA, TV SARANDA, TV SOT 7, TV BEST.

Në mbledhjen e datës 17.01.2023, ora 12:30, pas relatimit të z. Ledio Braho u konstatua se subjekti ankues nuk është autorizuar për përfaqësimin e OSHMA-ve të sipërcituara. Në mungesë të këtij autorizimi të posaçëm të subjektit ankimues, “Shoqata e Transmetuesve Radioteleviziv Kabllore Valore” nuk legjitimohet në cilësinë e subjektit ankimues.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

## V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 24, datë 06.01.2023, të paraqitur nga Shoqata e Transmetuesve Radioteleviziv Kabllore Valore për shkak moslegjitimitimi të ankuesit;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë, Tiranë brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

<b>Ledio</b>	<b>BRAHO</b>	-	<b>Relator</b>
<b>Elvin</b>	<b>LAKO</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Elvis</b>	<b>ÇEFA</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Ilirjan</b>	<b>RUSMALI</b>	-	<b>Anëtar</b>
<b>Koli</b>	<b>BELE</b>	-	<b>Anëtar</b>